



Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së);
- Vendimi i ZRRE-së nr. V_517_2013 për Të Hyrat Maksimale Të Lejuara (MAR) që do të mbulohen nga Operatori i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH); dhe
- Aplikacionin e KEDS-OSSH-së të dorëzuar me 21 janar 2015, kuadër të Shqyrtimit të Nëntë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE9) me dokumentacionin relevant sqarues.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur më 03 prill 2015 nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR)** që do të mbulohen nga Operatori i licencuar i **Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)** përmes ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes për vitin relevant tarifor SHTE9.

ARSYETIM


- ✚ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga KEDS aplikacionin e OSSH-së për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale, që duhet mbledhur nga OSSH-ja përmes ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes(DUOS).
- ✚ Në marrjen e vendimit të tij për MAR, që do të mbulohet nga OSSH, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim, që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
 - Vlerësimi përfundimtar – Detajet mbi Operatorin e sistemit të shpërndarjes dhe të furnizuesit publik , i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Vlerësimi i përfundimtar-Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Raport Konsultativ - Kalkulimi i Kostos së Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 09 Mars 2015;





- Raport Konsultativ - Kalkulimet e MAR-it të OSSH-së, i publikuar më datën 09 Mars 2015;
 - Përgjigjet ndaj Komenteve - Shqyrtimi i nëntë i tarifave të energjisë elektrike SHTE9, i publikuar me datën 03 prill mars 2015.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulojnë nga OSSH-ja për vitin relevant tarifor janë **75,592,539** euro.
 - III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH të paraqitura në tabelë do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes.
 - IV. Mbajtësi i licencës për OSSH duhet t'i përgatis dhe dorëzojë për aprovim ZRRE-së ngarkesat për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes (DUOS) të përcaktuar me këtë Vendim, brenda një afati sa më të shkurtë.
 - V. Ngarkesat e propozuara nga OSSH duhet të jenë në përputhje me Metodologjinë e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes të aprovuar nga ZRRE.
 - VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të përkthimeve, do të mbisundojë versioni i gjuhës shqipe.
 - VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga operatori i Shpërndarjes duke filluar nga 1 prilli 2015 deri në shqyrtimin e rregulltar tarifor, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE:


Enver Halimi, Kryesues


Merita Kostari, Anëtare


Krenar Bujupi, Anëtar